

MARMORINO CLASSICO

Veshje (Stuko) dekorative minerale për sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme, Lamato

PËRSHKRIMI

MARMORINO CLASSICO është veshje murale për sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme, me bazë lidhës minerale, që lejojnë krijimin e një finiture shumë të ngjashme me ndërtesat e vjetra në Venezia.

Produkti që punohet rezulton gjithmonë ndryshe, pasi karakterizohet nga hijet dhe efektet kromatike, të cilat varen nga aftësia dhe karakteristikat e dekoruesit.

MARMORINO CLASSICO krijon një shtresë të trashë, rezistente ndaj kushteve të ndryshme klimaterike dhe me transpirim të lartë. Produkti është veçanërisht i përshtatshëm për ndërhyrjet dhe restaurimet edhe në ndërtesat me interes të veçantë historiko-artistik.

UDHËZIME PËR PËRDORIM

I aplikueshëm në:

- Suvatime të reja dhe të vjetra.
- Sipërfaqe betoni.
- Bojatisje të vjetra me natyrë organike ose minerale, të thara, kompakte, absorbuese dhe kohezive.
- Sipërfaqe me natyrë të ndryshme minerale, me kusht që të jenë absorbuese.
- Sipërfaqet duhen përgatitur përshtatshëm duke ndjekur me kujdes paragrafin "Përgatitja e Sipërfaqes".
- Mos aplikoni në sipërfaqe të pathara mirë/freskëta.
- Nuk këshillohet përdorimi në sipërfaqe betoni për jashtë, pasi duke qenë se produkti ka përshkueshmëri të lartë, nuk siguron mbrojtje ndaj agresioneve të dioksidit të karbonit, arsyeja kryesore e degradimit të betonit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

- Forma e lidhësit: Gëlqere e imët
- Klasifikimi i cilësisë së ajrit Brenda: A+
- Tretësi: ujë
- Granulometria maksimale e kuarcit: 0,7 mm
- Viskoziteti: Në gjendje pastoze
- Përshkueshmëria e ujit likuid UNI EN 1062-3: mesatare, $w=0,20 \text{ kg/m}^2\text{h}^{0,5}$
- Përshkueshmëria e avujve të ujit UNI EN ISO 7783-2: e lartë $S_d=0,08$ për trashësi prej 0,7 mm
- Tharja (në 25 °C dhe 65% di U.R.): prekja pas 2-3 orësh; Shtresa tjetër pas 12 orësh (në bazë të trashësisë së aplikuar).

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet në suva:

- Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e maturuar (e tharë plotësisht) prej të paktën 28 ditësh.
- Kontrolloni gjendjen e sipërfaqes. Duhet të jetë e qëndrueshme. Në të kundërt siguroni konsolidimin me produkte specifike.
- Në prani të mykut, trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).
- Hiqni, me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, mykun present dhe pluhurat e bojës së vjetër.
- Në prani të bojrave të vjetra në gëlqere ose temperave/bojërave transpirante hiqni pluhurin dhe pjesën e sipërfaqes jo të aderuar.
- Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim.
- Çarjet, Brenda ose jashtë, duhet të zgjerohen sa duhet dhe të mbushen me llaç, stuko ose produkte të ngjashme.
- Niveloni parregullsitë e sipërfaqes. Plasaritjet dhe uljet mund të trajtohen me BETOMARC 9450150, me RASAMIX 9440160, me RASOMARC 9500150 në bazë të llojit të sipërfaqes.
- Vetëm në sipërfaqe pjesërisht të pluhurosura përdorni astarin e mikronizuar solvent free ATOMO 8840001.
- Në prani të sipërfaqeve jo-homogjene, me bojë të vjetër, stukime, uniformoni sipërfaqen paraprakisht nëpërmjet aplikimit të astarit MARCOSIL GRIP 9310019 ose MARCOTHERM PRIMER 4740019.
- Vazhdoni me aplikimin e MARMORINO CLASSICO sipas metodave të përshkruara në udhëzimet për aplikim.

* (Hollimi i astarit dhe sasia për t'u aplikuar janë në funksion të absorbimit të sipërfaqes dhe përcaktohen me prova paraprake në sipërfaqe specifike. Konsultohuni me skedën teknike përkatëse).

UDHËZIME PËR APLIKIM

- Duke qenë se tharja dhe karbonizimi i MARMORINO CLASSICO, si dhe të gjithë produktet në gëlqere, influencohen shumë nga kushtet e temperaturës dhe lagështirës, rekomandohet që të aplikohet me temperaturë

MARMORINO CLASSICO

Veshje (Stuko) dekorative minerale për sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme, Lamato

+10°C dhe +35°C dhe me lagështi relative të ambientit <75%.

-Shmangni aplikimet në prani të sipërfaqeve me kondensim ose nën veprimin e drejtpërdrejtë të diellit.

-Ekspozimi ndaj agjentëve atmosferike, shiut, lagështirës së lartë, temperaturave të ulëta të ambientit, të sipërfaqeve të trajtuara me produkte në gëlqere, mund të shfaqë fenomene zbeheje të sipërfaqes gjatë procesit të karbonizimit. Ky fenomen mund të rezultojë i pakthyesëm në kushte ekstreme.

-Pas aplikimit, sipërfaqet e jashtme duhet të jenë të mbrojtura nga shiu dhe lagështira deri në një tharje të plotë të produktit, që normalisht (në 20°C) ndodh për 72 orë.

-Nëse sipërfaqja nuk ka nevojë për astar, këshillohet që sipërfaqja të njomët, për të shmangur thithjen e ujit nga lidhësi.

-Mjetet: mallë inoksi, plastike, sfungjer, pinel.

-Nr. I shtresave: produkti aplikohet në të paktën 2 shtresa për përgatitjen e sipërfaqes/bazës.

-Hollimi: Gati për përdorim.

MARMORINO CLASSICO, duke qenë një produkt me natyrë minerale, gjatë magazinimit mund të rrisë viskozitetin, për të rivendosur origjinalin mjafton ta perzieni me mjete mekanike dhe shtimin e ujit maksimalisht deri në 1%.

Mënyra e aplikimit:

*Për efektin "tipo marmo":

-Mjetet: mallë inoksi ose plastike.

-Aplikoni një shtresë bazë për të barazuar sipërfaqen.

-Pas 12 orësh aplikoni një shtresë tjetër deri kur të arrini trashësinë e duhur;

-Sapo produkti të fillojë të shtrihet, aplikoni një sasi të vogël produkti, të njomë mbi të njomë, me qëllim mbushjen e poroziteteve të sipërfaqes.

-Më pas, vazhdoni me lucidimin.

Për efektin rustic (krijimin e ujrave) "tipo intonaco colorato":

-Mjetet: mallë inoksi / plastike me mallë në sfungjer,

-Aplikoni një shtresë bazë për të uniformuar sipërfaqjen.

-Pas 4-5 orësh aplikoni një shtresë tjetër deri kur të arrini trashësinë e duhur.

-Sapo produkti të fillojë të përhapet, vazhdoni me finiturën me mallë sfungjeri (mos lani

sipërfaqet ku punohet).

-Mjetet duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit me ujë.

-Shkalla e përhapjes (mbulimit): 2,5-3 kg/m² me 2 shtresa, në sipërfaqe lisho dhe mesatarisht absorbuese.

NGJYROSJA

Ngjyrosja mund të arrihet përmes sistemit Marcromie tintometric. Produkti gjithashtu mund të ngjyrosët me kolorantët COLORADO seri 548. Në rast të përdorimit të fabrikimeve të ndryshme është e këshillueshme të përzihen midis tyre produktet e ndryshme për të shmangur ndryshime në tonalitete. Në ndërhyrjet për jashtë ne rekomandojmë që të përfundoni punimin me materiale të të njëjtit prodhim. Për punë, në të cilat është i pashmangshëm përdorimi i një materiali të ri, mos e aplikoni afër materialit të përdorur më parë. Për rakordimin përdorni ndërprerjet e vazhdimësisë së sipërfaqes, mbulesave, skajeve, kablllove ose të tjera.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30° C

Temperatura minimale e ruajtjes: +5 ° C

Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite e BE-së (Dir. 2004/42/EC)

Cat. L bojë për efekte dekorative (bazë uji): 300 g/l (2007) / 200 g/l (2010)

MARMORINO CLASSICO përmban max: 30 g/l VOC/

Irritues. / Rrezik të rëndë okular. / Irritues për lëkurën. / Mbajeni larg përdorimit nga fëmijët. /

Shmangni kontaktin me sytë. / Në rast të kontaktit me sytë lajini menjëherë me ujë të bollshëm dhe konsultohuni me mjekun./ përdorni doreza të përshtatshme për të mbrojtur sytë, fytyrën. / Në rast të gëlltimit konsultohuni menjëherë me mjekun dhe l tregoni ambalazhin ose etiketën.

Produkti duhet të transportohet, përdoret dhe ruhet sipas rregullave aktuale të shëndetit dhe sigurisë; l thani mbetjet tërësisht dhe i trajtoni

MARMORINO CLASSICO

Veshje (Stuko) dekorative minerale për sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme, Lamato

ato si mbeturina të veçanta. Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Veshje murale, minerale. Aplikimi, mbi sipërfaqje të përshtatshme për veshje murale Marmorino Classico seri 947, me bazë gëlqere e imët, në të paktën 2 shtresa me karakteristika të përshkueshmërisë së avujve të ujit UNI EN ISO 7783-2: e lartë dhe përshkueshmëri të ujit likuid UNI EN 1062-3: mesatare.

Furnizimi dhe instalimi i materialit € per m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti i produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.

Eraldi ShpK